



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Nr. 122 / prot.
13

Vlorë, më 26.04.2021

VENDIM

Nr. 10, datë 21. 04. 2021

**PËR
MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E SENATIT
AKADEMIK**

Mbështetur në nenin 40 të Ligjit Nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenin 26 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe referuar shkresës nr. 642 prot, datë 15. 04. 2021 të Zv. Rektorit për kërkimin shkencor dhe zhvillimin institucional, Rektorati në mbledhjen e datës 21. 04. 2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Zv. Rektorit për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional ardhur me shkresën nr. 642 prot, 15. 04.2021.
2. T'i propozojë Senatit Akademik ndryshimin e vendimeve nr. 51, datë 20. 09. 20219 dhe nr. 74, datë 16. 06. 2020.
3. Bashkëlidhur shkresa nr. 642 prot, datë 15. 04. 2021.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ZV REKTOR PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

Nr. 642 Prot

Vlorë, më 15/04/2021

Lënda: Propozim për disa ndryshime në Vendimin e Senatit Akademik Nr.51, datë 20.09.2019, si dhe në Vendimin e Senatit Akademik me nr 74, datë 16.06.2020.

REKTOR
Prof. Dr Roland Zisi

I nderuar Z.Rektor,

Mbështetur në vendimin e Senatit Akademik me nr 74, datë 16.06.2020 "*Për Procedurën e analizës së pyetësorve të studentëve për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruar prej stafit administrativ dhe ndihmës-akademik të UV-së*", vlerësoj si të pa aplikueshëm këtë procedurë për arsye se:

- në fazën e dytë të procedurës është e paqartë se cilat janë strukturat në rektorat dhe dekanat të cilat ngarkohen për të bërë analizën dhe interpretimin e rezultateve të pyetësorve së bashku me rekomandimet përkatëse. Mos ngarkimi drejtëpërdrejtë i një strukture të caktuar krijon hapsirë për shmangie të realizimit të këtij procesi.

Për sa më lartë, mbështetur në në Ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "*Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", neni 103, pika 1 mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në Statutin e UV-së, neni 80 dhe 82 pika 2, si dhe në zbatim të Vendimit të Senatit Nr. 51, datë 20.09.2019 për "*Miratimin e Pyetësorit për Studentët për Vlerësimin dhe Përmirësimin e Cilësisë së Shërbimeve të ofruara prej stafit administrativ dhe ndihmës akademik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë*", nisur edhe nga fakti se Komisionet e Përhershme ende nuk janë ngritur, **sugjeroj** që të ngarkohet NJSBCVI si struktura përgjegjëse për analizën dhe interpretimin e rezultateve të pyetësorve së bashku me rekomandimet përkatëse.

Për të shmangur konfliktin e interesit si strukturë e përfshirë në pyetësorin e studentëve për Vlerësimin dhe Përmirësimin e Cilësisë së Shërbimeve të ofruara prej stafit administrativ dhe ndihmës akademik të UV-së, duke qenë se kjo strukturë nuk ofron shërbime drejtëpërdrejtë tek



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

ZV REKTOR PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

studentët dhe për këtë arsye heqja nga pyetëtori nuk çënon marrjen e informacionit mbi cilësinë e shërbimeve të ofruara objekt i vlerësimit, **sugjeroj** që në vendimin e Senatit Akademik nr. 51, datë 20.09.2019, të hiqet nga skeda e vlerësimit seksioni i pyetjeve për NJSBCVI, saktësisht seksioni P.1h.

Nëse sugjerimet e mësipërme do të merren në konsideratë propozoj ndryshimet respektive në Vendimet e Senatit Akademik bashkëidhur kësaj shkrese.

Zv Rektor

Phd. Enkelejd Mëhilli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2021

VENDIM

Nr. , datë . .2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR. 51,
DATË 20.09.2019 "PËR MIRATIMIN E PYETËSORIT PËR STUDENTËT PËR
VLERËSIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË SHËRBIMEVE TË OFRUARA
PREJ STAFIT ADMINISTRATIV DHE NDIHMËSAKADEMIK NË UV"**

Mbështetur në pikën 3 të nenit 46 në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, në mbledhjen e datës, . . 2021 në mbështetje të propozimit të Zv Rektorit për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional sipas shkresës me nr.....:

VENDOSI:

1. Në vendimin e Senatit Akademik nr. 51, datë 20.09.2019, të hiqet nga skeda e vlerësimit seksioni i pyetjeve për NJSBCVI, saktësisht seksioni P.1h.
2. Ky ndryshim pasqyrohet në pyetësorin e miratuar këtu bashkëlidhur.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi NJSBCVI si dhe sektori i IT-së.
4. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2021

VENDIM

Nr. , datë . .2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR. 74,
DATË 16.06.2020 " PËR PROCEDURËN E ANALIZËS SË PYETËSORËVE TË
STUDENTËVE PËR VLERËSIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË
SHËRBIMEVE TË OFRUARA PREJ STAFIT ADMINISTRATIV DHE NDIHMËS
AKADEMIK TË UNIVERSITETIT " ISMAIL QEMALI", VLORË"**


Mbështetur në nenit 38, pika 1, shkronja j, nw nenin 103, pika 1 në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin 80 në Statutin e UV-së si dhe në zbatim të Vendimit të Senatit Nr. 51, datë 20.09.2019 për "Miratimin e Pyetësorit për Studentët për Vlerësimin dhe Përmirësimin e Cilësisë së Shërbimeve të ofruara prej stafit administrativ dhe ndihmës akademik të Universitetit " Ismail Qemali" Vlorë", Senati Akademik i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, në mbledhjen e datës, . . 2021 në mbështetje të propozimit të Zv Rektorit për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional sipas shkresës me nr.....,:

VENDOSI:

1. Në miratojë ndryshimet në procedurën e analizës së pyetësorëve të studentëve për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara prej stafit administrativ dhe ndihmës akademik të Universitetit " Ismail Qemali", Vlorë.
2. Procedura e e analizës dhe vlerësimit të pyetësorve e ndryshuar është si më poshtë:

A. Faza e parë: Plotësimi i pyetësorëve prej studentëve; Kohëzgjatja: Java e parë e muajit qershor deri në javën e parë të muajit korrik të çdo viti akademik.

- a. Pyetëtori i Miratuar me Vendim Senati Nr. 51, datë 20. 09. 2019, i ndryshuar, në javën e parë të muajit Qershor të cdo viti akademik do të hidhet në sistemin UVMS në Seksionin e Anketimeve prej Sektorit IT të Institucionit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

- b. Çdo student frekuentues nëpërmjet llogarisë së tij personale në UVMS plotëson pyetësozin në përfundim të vitit akademik.
- c. Afati i plotësimit të pyetësozit prej studentëve është periudha prej muajit qershor deri në fund të javës së parë të muajit korrik të cdo viti akademik.
- d. Në përfundimit të afatit të plotësimit të pyetësorëve, përgjegjësi i sektorit të IT-së i përcjellë bazën e të dhënave të gjeneruar prej sistemit UVMS Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional.

B. Faza e dytë: *Analizimi i rezultateve të pyetësorëve të studentëve dhe hartimi i rekomandimeve; Kohëzgjatja: Korrik-Shtator*

- a. NJSBCVI përpilon raportin e detajuar të analizës dhe rezultateve të pyetësorëve brenda dy muajve nga përfundimi i afatit të plotësimit të pyetësorëve, të cilën e përcjell pranë Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët në Nivel Institucioni (KMSNI).
- b. KMSNI sëbashku me NJSBCVI brenda muajit shtator të cdo viti akademik mbështetur në raportin e detajuar të hartuar prej NJSBCVI, përpilojnë rekomandimet për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara prej stafit administrativ dhe ndihmës-akademik të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
- c. Raporti i detajuar i analizës së rezultateve si dhe rekomandimet përkatëse i përcillen Rektorit të UV-së, i cili e përcjell më tej pranë Dekanëve, Administratorit si dhe Zv Rektorëve, ku këta të fundit e shpërndajnë tek strukturat e varësisë që janë subjekt i këtij pyetësozi.

C. Faza e tretë: *Diskutimi dhe hartimi i planit të masave, Kohëzgjatja: Shtator-Tetor*

- a. Brenda 20 ditëve pas marrjes së raportit të detajuar të analizës së rezultateve si dhe rekomandimet përkatëse, drejtoritë dhe strukturat e tjera të përfshirë në pyetësoz diskutojnë me personelin e varësisë dhe përpilojnë planin e masave për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara respektivisht prej tyre, të cilin ja përcjellin më tej sipas varësisë Administratorit, Dekanëve, Zv Rektorëve. Këta të fundit e përcjellin për diskutim dhe miratim të mëtejshëm pranë Rektorit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

- b. Rektori në mbledhjen më të afërt të Rektoratit (por jo më vonë se muaji tetor) propozon për diskutim dhe miratim planin e masave për cdo strukturë të përfshirë në pyetësinë e studentëve.
- c. Plani i Masave i miratuar me vendim rektorati ju përcillet për zbatim të gjitha strukturave të përfshira në të.

D. Faza e katërt: Publikimi dhe Monitorimi, Kohëzgjatja: Nëntor-Shtator

- a. NJSBCVI është përgjegjëse për publikimin e raportit të rezultateve të pyetësorëve së bashku me rekomandimet si dhe planin e masave, duke respektuar Ligjin Nr.9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
 - b. NJSBCVI është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të planit të masave dhe raporton tek Rektori për realizimin/mosrealizimin e tij, sipas afateve të përcaktuara në planin e masave.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Dekanët, Zv Rektorët, NJSBCVI, Sektori IT si dhe gjithë personeli administrativ dhe ndihmës-akademik i përfshirë në këtë procedurë.
 4. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI